



Pranuar / Dorezuar Prijmjenos/Prodato Received/Delivery	27.07.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHACK	4370/2022		113



Republika e Kosovës  
 Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.442/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.494/2021 të datës 04.07.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.442/2019 të datës 02.08.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi në

kundër organit të punësimit/Komunës së Podujevës, në çështjen juridike "kompensim material" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 27.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.442/2019 e datës 02.08.2019 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi, tani i pensionuar, me datë 02.08.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3409/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër përgjigjes me numër reference 03-311/2019 të datës 12.07.2019 të Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Podujevës, me pretendimin se sipas rregulloreve dhe kontratave kolektive ankuesit me rastin e pensionimit i takojnë tri paga përcjellëse dhe tri paga jubilarë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datën 06.08.2019 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Podujevës, ndërsa kjo e fundit më datë 15.08.2019 ka dërguar në Këshill shkresat ndërlidhur me këtë çështje juridike-administrative.

Këshilli përmes shkresës me numër protokollit 4254 të datës 10.09.2019 ka njoftuar ankuesin lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar të njëjtin lidhur me të drejtën e inicimit të konfliktit administrativ në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 04.07.2022 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.494/2021 me të cilin ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesën e datës 02.08.2019 të parashtruar nga ankuesi Selim Durmishi.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit 3409/2019 të datës 02.08.2019 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.02-118/02-0032058/19 të datës 15.04.2019 të Kryetarit të Komunës së Podujevës; Formularin për kërkesë apo ankesë i datës 14.06.2019; Kërkesën e datës 14.06.2019 e parashtruar nga ankuesit për Drejtorinë e Personelit të Komunës së Podujevës; Përgjigjen me numër reference 03-311/2019 të datës 12.07.2019 të Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Podujevës; Letërnjoftimin e ankuesit dhe Përgjigjen në ankesë të datës 15.08.2019 me numër protokollit 3592/2019; Njoftimin e datës 10.09.2019 për ankuesin; Aktgjykimin A.nr.494/2021 të datës 04.07.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesit, është e palejuar, sepse:

Nga administrimi i provave të provave të lëndës është konstatuar së ankuesi ka qenë i punësuar si nëpunës civil në Komunën e Podujevës në pozitën *Inspektor*. I njëjtit me Vendimin me Nr.02-118/02-0032058/19 të datës 15.04.2019 të Kryetarit të Komunës së Podujevës, i është ndërprer marrëdhënia e punës duke filluar nga data 02.05.2019, për shkak arritjes së moshës së pensionit, ndërsa me Vendimin me Nr.02-118/02-0032058/19 të datës 15.04.2019 të Kryetarit të Komunës së Podujevës, ankuesit i është njohur kompensimi i një page të menjëhershme në vlerën prej 520 euro.

Ankuesi më datë 14.06.2019 ka parashtruar kërkesë tek Drejtoria e Personelit në Komunën e Podujevës për pagesën edhe të dy pagave përcjellëse dhe tri pagave jubilarë, kurse në përgjigje të kërkesës së ankuesit më datë 12.07.2019 Ushtruesi i Detyrës i Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Podujevës, të njëjtin e ka njoftuar se në bazë të nenit 19 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë, nëpunësit civil me rastin e pensionimit i paguhet një pagë mujore në vlerën e pagës së fundit si dhe ka udhëzuar ankuesin lidhur me të drejtën e ushtrimit të ankesës në *Komisionin për Ankesa në afat prej 30 ditëve*.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga shqyrtimi i shkresave të këndës ka gjetur se në kohën e pensionimit të ankuesit ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës sipas të cilit me nenin 81 është përcaktuar se: *1.Organe të veçanta për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil do të themelohen në kuadër të secilit institucion të administratës qendrore dhe komunale, që ka nëpunës civilë. 2. Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, ndërlidhur me këtë, neni 4 paragrafi 1 i Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave ka specifikuar se: nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje apo lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës”, e mbi këtë bazë ligjore rrjedhë se ankuesi në rast të pakënaqësisë së kompensimit me rastin e pensionimit, respektivisht lidhur me përgjigjen e Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Podujevës të datës e 12.07.2019, është dashur që të ushtroj fillimisht ankesë të brendshme gjegjësisht në Komisionin për Zgjidhjen e*

Kontesteve dhe të Ankesave pranë Komunës së Podujevës, e me tej në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 50 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: "Nëpunësit civilë kanë të drejtë mbrojtjeje përmes procedurave të brendshme administrative ose gjyqësore në rast të shkeljes së të drejtave të tyre, që rezulton nga një veprim i administratës publike".

Ndërlidhur si me lart, Kolegji i Këshillit me rastin e vendosjes ju referua edhe dispozitave të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përkatësisht nën 16 paragrafi 4 me të cilin është përcaktuar se: "Para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shterur procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit", andaj në kuptim të dispozitave ligjore si më lart dhe duke marrë parasysh se me asnjë provë nuk dëshmohet se ankuesi të ketë ushtruar paraprakisht ankesë të brendshme gjegjësisht në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave pranë organit të punësimit, kështu që, nisur nga ky konstatim si dhe në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vlerësoj se ankesa me numër A.nr.442/2019 e datës 02.08.2019 është e papranueshme.

Theksuar si më lartë, Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

#### **Këshillë juridike:**

*Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

### **KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS** Lënda me numër A.nr.442/2019

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

#### **Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Podujevës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Podujevës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së